



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri: KSC-BC-2020-05
Vendosi: Gjykatësi i Procedurës Paraprake
Gjykatës Nikola Giju
Administratore: Dr. Fidelma Donlon
Data: 26 maj 2020
Gjuha: Anglishte
Klasifikimi: Rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*

URDHËR

për caktimin e datës së synuar për marrjen e vendimit sipas nenit 39(2)

Prokurori i Specializuar

Xhek Smith

GJYKATËSI I PROCEDURËS PARAPRAKE,¹ në bazë të nenit 39(2) të Ligjit nr. 05/L-053 mbi Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”) dhe rregullën 85(5) të Rregullores së Procedurës dhe Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Rregullorja”), lëshon urdhrin e mëposhtëm.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 14 shkurt 2020, Prokurori i Specializuar dorëzoi për konfirmim një aktakuzë rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte* së bashku me materialet provuese në mbështetje të fakteve mbi të cilat bazohen akuzat si dhe një përmbledhje të detajuar në të cilën tregohet lidhja e secilës prove me secilën akuzë.²
2. Më 28 shkurt 2020, Gjykatësi i Procedurës Paraprake urdhëroi ZPS-në që deri më 18 mars 2020 të dorëzonte, ndër të tjera, një aktakuzë të rishikuar.³
3. Më 18 mars 2020, ZPS-ja dorëzoi për konfirmim⁴ një aktakuzë të rishikuar. Një aktakuzë e rishikuar për herë të dytë u dorëzua më 20 mars 2020.⁵
4. Rregulla 85(5) e Rregullores përcakton më tej që Gjykatësi i Procedurës Paraprake duhet të caktojë një datë të synuar për vendimin e vet, në bazë të nenit 39(2) të Ligjit, e cila nuk duhet të jetë më vonë se gjashtë muaj nga dorëzimi i aktakuzës dhe i gjithë materialit mbështetës.

¹ KSC-BC-2020-05, F00001, Kryetarja, *Vendim për caktimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake*, 14 shkurt 2020, publik.

² KSC-BC-2020-05, F00002, Prokurori i Specializuar, *Parashtrim i Aktakuzës për konfirmim dhe kërkesat në lidhje me të*, 14 shkurt 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, me Shtojcat 1-3, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*.

³ KSC-BC-2020-05, F00003, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Urdhër drejtuar Prokurorit të Specializuar në përputhje me rregullën 86(4) të Rregullores*, 28 shkurt 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*.

⁴ KSC-BC-2020-05, F00004, Prokurori i Specializuar, *Parashtrim i Aktakuzës së Rishikuar për konfirmim dhe kërkesat në lidhje me të*, 18 mars 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, me Shtojcat 1 dhe 2, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*.

⁵ KSC-BC-2020-05, F00005, Prokurori i Specializuar, *Parashtrim i Aktakuzës së Rishikuar për herë të dytë për konfirmim*, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, me Shtojcën 1, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*.

II. VENDIM

5. Gjykatësi i Procedurës Paraprake në vijim:

VENDOS që një vendim në përputhje me nenin 39(2) të Ligjit do të lëshohet më 12 qershor 2020.

/nënshkrimi/

Gjykatës Nikola Giju
Gjykatës i Procedurës Paraprake

E martë, 26 maj 2020,

Në Hagë, Holandë.